



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 415/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Milazim Halitit kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. MIRATOHET** si e bazuar ankesa e Milazim Halitit kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)
- II. URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektit politik LDK në Vendvotimin 2513D/04D
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit si në pikën –II- të këtij dispozitivit të përfshihet në rezultatit përfundimtar.

**Arsyetim**

Me datë 27.06.2014 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Milazim Halitit kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me numër 74 në të cilën thekson se në FRK ka zero vota ndërsa kandidatit me numër 23 i janë shënuar 25 vota ndërsa kandidatit me numër 33 i janë shënuar 18 vota dhe si dëshmi për këtë ka bashkangjitur edhe FRK-në.

Bazuar në nenin 117.2 të LZP-së PZAP-i “*Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme*”

PZAP-i pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri hetimin e fletëvotimeve të kontestuara gjeti se:

**ankesa është e bazuar**

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga Milazim Halitit kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati

në fjalë pretendon se votat e tij se i janë regjistruar kandidatit tjetër nga subjekti politik LDK.

Nga ekipi hetues i PZAP-it është hapur kutia e votimit me numër 2501X/08R për e cila kuti ka qenë e mbyllur me 4 shirita anësor të sigurisë të cilët shirita kanë mbajtur këta numra: 141717, 141718, 141715 dhe 141716 si dhe shiritin e sigurisë i cili gjendej në mes të kutisë së votimit me numër 000409 e i cili nuk është prekur fare prandaj edhe ka mbetur i njëjti.

Pas hapjes së kësaj kutie PZAP-i ka gjetur se në këtë vendvotim ka pasur pa rregullsi gjatë plotësimit të FRK-ve duke ju shënuar gabimisht votat kandidatëve të tjerë.

PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron KQZ-në që për këtë vendvotim të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për të gjithë kandidatët e subjektit politik LDK, dhe se mbi këtë bazë e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 415/2014 më datën 30.06.2014



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.